



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 19.3.2019

Dokument parlamentar

RAPORT PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2016 PËR PROJEKTIN “PROGRAMI I INVESTIMEVE PËR SHPËRNDARJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE I”

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32 - 38 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2016 për projektin “Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I”, në mbledhjen e tij të datës 19 mars 2019.

Komisioni caktoi relator për këtë projektligj Zonjën Eglantina GJERMENI.

Të pranishëm gjatë shqyrtimit të projektligjit ishin përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe të OSHEE sh.a.-së.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2016 për projektin “Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit financiar 2016 për projektin “Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I”, nëpërmjet së cilës qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë një kredi të butë dhe një shumë financimi nga KfW-ja, për projektin “Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I”. Vlera e kësaj marrëveshjeje është 32 milionë euro.

Projekti “Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I” do të ndikojë në përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes, si dhe rritjen e cilësisë dhe sigurisë së furnizimit me energji elektrike për klientët.

Po ashtu, projekti do të mbështesë dixhitalizimin e menaxhimit të rrjetit të OSHEE-së duke zgjeruar dhe përmirësuar qendrën e kontrollit të shpërndarjes me një sistem të fjalës së fundit IT për Sistemin e Kontrollit dhe Menaxhimit të të Dhënave (SCADA) etj. Furnizimi i qëndrueshëm me energji elektrike do të përmirësojë klimën e biznesit dhe kushtet e jetesës në Shqipëri.

Ky investim është pjesë e një pakete mbështetëse të financuar nga Qeveria Gjermane përmes KfW-së e cila përfshin:

- shërbime këshilluese menaxheriale për OSHEE-në;
- përgatitjen e një plani për zhvillimin e rrjetit; si edhe
- përgatitjen e një plani investimesh për sistemin e shpërndarjes.

Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose marrësve të tjerë të cilët do të zgjidhen bashkërisht nga të dy Qeveritë, të marrin nga KfW për projektin "Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I" shumat e mëposhtme:

- Një kredi të butë të KfW-së, e cila jepet në kuadër të bashkëpunimit publik për zhvillim, në vlerë 30 000 000 euro nëse nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur. Ky projekt nuk mund të zëvendësohet nga projekte të tjera.
- Një shumë financimi prej gjithsej 2 000 000 euro për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikqyrjen e projektit.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë në rastet kur ai vetë nuk është huamarrësi, do të garantojë ndaj KfW-së të gjitha pagesat në euro për shlyerjen e borxheve të huamarrësve, që mund të lindin në bazë të kontratave. Gjithashtu, në rastet kur ai vetë nuk është marrësi i shumës së financimit, do të garantojë ndaj KfW-së të gjitha pagesat për shlyerjen e detyrimeve që mund të lindin në bazë të kontratave të financimit.

KfW-ja përjashtohet nga të gjitha tatimet dhe taksat e tjera publike, që lindin në Republikën e Shqipërisë, në kontekstin e lidhjes dhe të zbatimit të kontratave që do të lidhen ndërmjet KfW-së dhe marrësve të huave dhe shumave të financimit.

Premtimi i shumave të përmendura në këtë marrëveshje, konsiderohet i pavlefshëm, nëse kontratat përkatëse të huas dhe të financimit nuk lidhen brenda gjashtë vitesh. Afati për shumat e përmendura në këtë marrëveshje mbaron në datën 31 dhjetor 2022.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, si dhe me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 2 nene.

- ***Diskutimi në komision***

Relatori i projektligjit u shpreh që realizimi i këtij programi do të ndikojë në përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes, si dhe rritjen e cilësisë dhe sigurisë së furnizimit me energji elektrike për klientët.

Përfaqësuesit e Ministrisë shpjeguan elementët kryesorë të kësaj marrëveshjeje duke e konsideruar atë si shumë të rëndësishme për zhvillimin e projekteve në rrjetin e shpërndarjes së energjisë. Projektet do të jenë kryesisht në nënstacione, fidra, etj.

Diskutimet në Komision, u përqëndruan kryesisht në gjendjen, ecurinë dhe treguesit aktualë të rrjetit të shpërndarjes; termat financiarë që do të kenë marrëveshjet financiare; si dhe projektet konkrete që mund të realizohen me këtë marrëveshje.

- ***Përfundim***

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vlerësoi projektligjin për krijimin e mundësive për përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Komisioni e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

Eglantina GJERMENI

Niko PELESHI

Relator

Kryetar